

# AKT - THEMELIMI

## I SHOQERISE TREGTARE "DEAS-CONSTRUZIONI" SH.P.K TIRANË

Në Tiranë, sot më dt 11.12.2023 (Njëmbëdhjet dhjetor dy mijë e njëzet e tre) unë, shtetasi Shqiptar **DASHAMIR KACANI**, i biri Eminit dhe i Shyqyrjes i datëlindjes 15.06.1972, lindur në Yrshek, Tiranë dhe banues në Tiranë, rruga "Myslym Keta", Nd.038; H 0; Ap 0; Njësia Administrative nr 4, Bahkia Tiranë mbajtes i Pasaportës me Nr. BE6623679 dhe numër personal H20615236W, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili me vullnetin tim të lirë dhe nëpërmjet Përfaqësuesit tim Ligjor të pajisur me prokurën nr.2416 rep, nr.763 kol, kam vendosur krijimin e akt themelimit të shoqërisë "**DEAS-CONSTRUZIONI**" SH.P.K TIRANË.

Në bazë të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për shoqërite tregtare"(të ndryshuar) dhe Ligjit Nr.131/2015 "Per Qendren Kombetare te Biznesit" dhe të ligjeve të tjera që lidhen me veprimtarinë tregtare në Republikën e Shqipërisë, me vullnetin e tij të lire, themelon shoqërinë si më poshtë vijon .

### NENI 1

#### THEMELIMI I SHOQERISE

Ortaku i vetëm themelues, shtetasi shqiptar **DASHAMIR KACANI** themelon Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar, të emërtuar "**DEAS CONSTRUZIONI**" SH.P.K TIRANË.

Shoqëria, e formuar me iniciativën e ortakut themelues, konsiderohet e themeluar në përputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj bashkangjitur këtij akti. Shoqëria i nënshtrohet legjislacionit shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do t'i nënshtrohen legjislacionit të vendit ku do të ketë qendrën dega

Degët e shoqërisë do të ushtrojnë veprimtarinë në emër dhe për llogari të kësaj shoqërie dhe brenda kompetencave që do t'u jepen në aktet e krijimit apo me akte të tjera të veçanta.

### NENI 2

#### E DREJTA

"**DEAS CONSTRUZIONI**" SH.P.K TIRANË është person juridik i së drejtës shqiptare e themeluar me vendim të ortakut themelues që ushtron veprimtarinë e saj tregtare në përputhje dhe në zbatim të legjislacionit shqiptar në fuqi të ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare" (të ndryshuar) dhe Ligjit Nr. 131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".



### NENI 3

#### PËRGJEGJËSIA

Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe do të përballojë humbje deri në kufirin e kontributit të themeluesit të saj në kapitalin themeltar.

Shoqëria përgjigjet me pasurinë e saj për detyrimet e saj ndaj te tretëve.

Ajo nuk përgjigjet për detyrimet e ortakut në veçanti, po për humbjet e shoqërisë deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

### NENI 4

#### SELIA E SHOQERISE

Shoqëria e ka selinë e saj në Tiranë, rruga "Xhon Belushi", Godinë banimi 2 kate, nr 22; nr pasurisë 178/118; Zona Kadastrale 2460; Njësia Bashkiake nr 4 Tiranë.

Ajo mund të çelë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe me miratim të organeve kompetente edhe jashtë vëndit.

### NENI 4

#### KOHEZGJATJA

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar mbi 10 vjet me përjashtim të rastit kur ortaku vendos një prishje të parakohshme të saj ose vendos për shtyrje të mëtejshme, etj.

### NENI 5

#### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

**Objekti i veprimtarise se saj do te jete:**

- Ndërtim dhe zbatim të veprave ndertimore të të gjitha llojeve sipas legjislacionit shqiptar.
- Investime në ndërtime civile, palate, vila individuale dhe në ndërtime turistike.
- Ndërrmarje ndërtimi për vete dhe për llogari të të tretëve në kryerjen e veprimtarive ndertimore, ndërtime civile, industriale, bujqësore, turistike dhe kompletimi me instalimet elektrike, hidrosanitare..etj që lidhen me to.
- Ndërtim, zbatim e rikonstruksion te: godinave të të gjitha llojeve, rrugë të ç' do kategorie, autostrada, mbikalime, hekurudha, punime nëntokësore, ura e vepra arti, ujesjellesa, gazsjellësa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje,
- Ndërtime hidroteknike, mbrojtje lumore, sistemime hidraulike e bonifikime, barriera dhe mbrojtje lumore, diga, damba, tunele. ndërtime për n/stacione elektrike, linja të tensionit të lartë të ulët e të mesëm dhe shperndarjen e energjisë.
- Ndërtim impjante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri dhe mirëmbajtjen e tyre.
- Import-eksport sipas legjislacionit shqiptar.
- Projektim ; hartimi i projekteve të ndërtimit dhe zbatimi i tyre.

### NENI 6

#### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000 (dhjetë mijë) lek i përbërë nga kontributi i ortakut të vetëm.



Ky kapital nuk ndahet, dhe vlera e kapitalit themeltar eshte 100 % një kuotë e vetme që i përket ortakut të vetëm **DASHAMIR KACANI**, kuotë e cila mund të tjetërsohen pjesërisht ose tërësisht. Kapitali themelues mund të ndryshojë sipas vendimit që mund të marrë ky ortak, por asnjehere nuk mund të pakesohet nën nivelin e kapitalit themeltar.

Kapitali është tërësisht i shlyeshëm e i nënshkrueshem.

Ky kapital themeltar është i depozituar në bankë.

#### **NENI 7**

#### **VULA E SHOQËRISË**

Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtje: **“DEAS CONSTRUZIONI”SH.P.K TIRANË**

#### **NENI 8**

#### **DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë :

- Mbledhja e Ortakeve – Ortaku i vetëm
- Administratori

Fusha e veprimt, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet në statut.

#### **NENI 9**

#### **KOMPETENCA**

Në përputhje me ligjin për ushtrimin e këtij aktiviteti, shoqëria ka të drejtën e emërimit apo dhe të shkarkimit të Drejtuesit Teknik të saj.

Kopetencat dhe detyrat e Drejtuesit Teknik janë të përcaktuara në statutin e shoqërisë.

Administrator i **“DEAS CONSTRUZIONI”SH.P.K TIRANË** është **DASHAMIR KACANI**.

Afati i qëndrimit në detyrë të Administratorit është 5 vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

#### **NENI 10**

#### **BAZA LIGJORE PËR NDRYSHIMET**

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin e saj, administratorët, kapitalin, selinë, ortakët, objektin e veprimt, etj, sipas vendimit që do të merret nga Mbledhja e Ortakëve-Ortaku i Vetëm dhe sipas kërkesave të Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 “Per shoqerite Trgetare” duke depozituar vendimin pranë rregjistrir tregtar të Qëndrës Kombëtare të Biznesit.

#### **NENI 11**

#### **LLOGARITË**

Shoqëria do të realizojë transaksionet e saj financiare nëpërmjet llogarive rrjedhëse që do të hapen në bankat shqiptare dhe të huaja.

Për kapitalin themeltar të shoqërisë është hapur libri i llogarive dhe shoqëria ka dhe perdor dokumentacionin financiar në përputhje me dispozitat në fuqi për kontabilitetin dhe dispozitave të tjera fiskale.

#### **NENI 12**



## BILANCI

Veprimet ekonomike dhe financiare të shoqërisë do të mbyllen në 31 dhjetor të cdo viti.

Viti ushtrimor do të përkojë me vitin kalendarik.

Vetëm për vitin e parë ushtrimor do të kihet parasysh periudha që shtrihet nga momenti i regjistrimit në organin tatimor deri në datën 31 dhjetor.

## NENI 13

### PERFAQSIMI

E drejta për të përfaqësuar shoqërinë para ç'do organi shtetëror, privat, bankar , gjyqsor , etj ushtrohet nga Administratori i Shoqërisë ose nga një person tjetër i autorizuar me prokurë nga Administratori.

## NENI 14

### ZBATIMI I LIGJIT

Persa nuk është shprehur në këtë Akt Themelimi dhe Statut, vlejné dispozitat e Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Shoqëritë Tregtare”(i ndryshuar) ; Ligjit Nr. 131/2015 “Për Qëndrën Kombëtare të Biznesit” dhe ligjeve të tjera që lidhen me veprimtarinë tregtare në Republikën e Shqipërisë.

## NENI 15

### VLEFSHMERIA E AKTIT TE THEMELIMIT

Shoqëria konsiderohet e krijuar në përputhje me nenet e këtij akti – themelimi dhe të statutit bashkelidhur aktit.

## NENI 16

Ky akt përpilohet në disa kopje për t’ju shpërndar organeve kopetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin e shoqërisë dhe nënshkruhet me vullnet te lire nga ortaku i vetem nëpërmjet përfaqësuesit Ligjor Leonard Çullhaj .

THEMELUES  
ORTAK I VETËM  
DASHAMIR KACANI

PËRFAQËSUESI LIGJOR  
Av. LEONARD ÇULLHAJ

*Av. Leonard Çullhaj*